



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.7/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për çështje Ekonomike, gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit: Qeveria e Kosovës-Ministria e Infrastrukturës-Drejtoria e Rrugëve të Kosovës me adres ish ndërtesa e Gërmisë- Prishtinë, kundër debitorit: N.T.SH “ B....” me numër të biznesit ....., me pronar I.B. me adres Rr. ....-Kamenicë, që ka të bëjë me pagesën e faturës-borxhit, si objekt i përbarimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit përbarimor të lejuar nga Zyra Përbarimore Vais Law, me Përbaruesin Privat Isa Gacaferi P.nr.147/2018 të dt:08.02.2018, mbi caktimin e përbarimit, me dt:29.09.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET, prapësimi i debitorit: N.T.SH “B....” me numër të biznesit ....., me pronar I.B. me adres Rr. ....-Kamenicë me adres Rr. ....-Kamenicë, i ushtruar kundër Urdhrit të Përbaruesit Privat P.nr.147/2018 të dt:08.02.2018, **si i bazuar.**

II.SHFUQIZOHET Urdhrit të Përbaruesit Privat Isa Gacaferi P.nr.147/2018 të dt:08.02.2018, mbi caktimin e përbarimit.

A r s y e t i m

Përbaruesit privat me seli të zyrës në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm– faturës B-46/2015 e datës 20.08.2015 dhe B-46/2014 e datës 20.08.2014 të cilat paraqesin dokumente përbaruese në bazë të nenit 21 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përbarimit, brenda afatit ligjor, debitori ka paraqitur prapësim, me të cilin ka deklaruar se e kundërshton ekzistimin e një borxhi kryesor, po ashtu edhe kamatën sipas ligjit, i njëjti tutje ka theksuar se kjo pompë e benzinës i ka kryer të gjitha obligimet ligjore ndaj Shtetit dhe Komunës së Kamenicës edhe pse jemi të hendikepuar për arsye se kemi qarkullim të ulëte sa i përket afarizmit që ushtrojmë. Me tej debitori ka theksuar se sipas Udhëzimit Administrativ nr.2005/13 konkretisht në nenin 1 nuk parashihet fare vendi ku gjendet pompa e benzinës të kategorizohen si rrugë magjistrale apo regjionale. Për këto arsye neve na bëhet e pa drejt në përcaktim të kësaj takse për shfrytëzimin e brezit rrugor duke na krahasuar me ato pompa në rrugë regjionale dhe autostrada.

Duke u bazuar në të lartcekurat, debitori i përbarimit i kishte propozuar Gjykatës që prapësimin e debitorit të aprovoj dhe të shfuqizohet urdhri përbarimor.

Kundër prapësimit të debitorit, kreditori kishte ushtruar përgjigje në prapësim me të cilin kishte theksuar se duhet të hedhen poshtë kontestimin e debitor në prapsim ngase fatura B-46/2015 e datës 20.08.2015 dhe B-46/2014 e datës 20.08.2014 është llogarit sipas Udhëzimit Administrativ

1/2014 mbi caktimin e tarifave për kyçje në rrugë dhe shfrytëzimin e tokës e cila i takon rrugës magjistrale dhe regjionale i cili udhëzim ka hyrë në fuqi me datë 23.04.2014. Kreditori i ka propozuar gjykatës që të aprovohet propozimi për përmbarrim sepse ka bazë ligjore pasi që me kërkesën e pronarit të subjektit ekonomik i ishte dhënë pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj rruge i cili njeherit ka nënshkruar kontrate e cila mban numrin 82/13 e datës 06.06.2000 me Drejtorin e rrugëve për shfrytëzimin e këtij brezi rrugor. Prandaj kreditori i ka propozuar gjykatës se pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të miratoj urdhrin përmbarrimor dhe debitorit t'ia refuzoj prapësimin.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve prapësuese me prapësim të debitorit të përmbarrimit, propozimit për përmbarrim dhe analizimit të shkresave të lëndë, me rastin e rishikimit të procedurës në këtë çështje përmbarrimore, vendosi se përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarrimor për faktin se, dokumentet e besueshme-faturat me B-46/2015 datë 20.08.2015 dhe fatura B-46/2014 datë 20.08.2014, nuk janë pranuar dhe nënshkruar nga debitori i përmbarrimit, këtë fakt Gjykata vërteton se fatura të cilat janë objekt i përmbarrimit nuk janë konfirmuar nga debitori se janë pranuar në mënyrë të rregullt, prandaj gjykata erdhi në përfundimin se përmbarrimi në këtë çështje përmbarrimore është caktuar pa u plotësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhrin përmbarrimor të parapara me dispozitat e LPP-së konkretisht neni nenin 29 par.3, për faktin se dokumentet e besueshme-faturat me numër B-46/2015 datë 20.08.2015 dhe B-46/2014 datë 20.08.2014 mbi bazën e të cilave është ushtruar propozimi për përmbarrim, nuk janë të papërshtatshme për përmbarrim, andaj se të tilla nuk mund të trajtohet se dokumente të besueshme.

Pas konstatimit të gjendjes faktike në këtë procedurë përmbarrimore, gjykata ju referua nenit 43.4 të LPP-së në të cilin nder të tjera është rregulluar se: “ Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.

Nga arsyet e paraqitura, e në bazë nenin 43 par. 4 dhe 73 të LPP-së si dhe për Plotësim Ndryshimin e ligjit e me numër Nr.05/L-118 te ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.7/22, dt.29.09.2022

Gj y q t a r i  
Alajdin Tërshnjaku

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Dhomat e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.